15.08.2011

Komente lidhur me: Rregullat për Tarifat e Sektorit të Energjisë Elektrike

Çështjet e komentuara:

- *Rishikimi i Rregullave për Tarifa të Energjisë Elektrike – Dokument Sqarues*
- *Rivlerësimi i Bazës së Rregulluara të Aseteve – Raport Konsultativ*
- *Rregullat për vënien e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit (Rregulla për Çmimet e OST-së)*

Komentet:

Hyrje

Më 1 gusht të vitit 2011, ZRRE nxori dokumentet konsultative të titulluara "Rishikimi i Rregullave për Tarifa të Energjisë Elektrike – Dokument Sqarues", "Rivlerësimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve – Dokument Këshillëdhënës", dhe "Rregulla për vënien e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit (Rregulla për çmimet e OST-së)", të cilave bashkërisht u referohemi si "dokumenti" dhe lidhur me të cilat është kërkuar përgjigja jonë. Dokumenti në vijim është përgjigja e dhënë nga KOSTT-i; ai përfshin vetëm pikat të cilat janë relevante për rolin të cilin KOSTT luan si Operator i Sistemit të Transmisionit dhe Operator i Tregut.

Përgjigja jonë i referohet pikave përkatëse nga dokumenti këshillëdhënës i ZRRE-së.

Në disa raste duket se nuk ka konsistencë mes versioneve të këtij dokumenti në gjuhën angleze dhe shqipe (p.sh. Shtojca 1 i Rregullës për Vënien e Çmimeve të OST-të në formulë ka edhe përkufizimin dt, por në versionin në gjuhën shqipe nuk ka përkufizim të tillë). Mes dy dokumenteve duhet të ketë konsistencë, në veçanti tek Kapitulli 1 (neni 3 _ 3.15), Neni 8 (1), Neni 8 (7) Kapitulli 4, Neni 14 (1.1) dhe Shtojca 2 (6.4).

Dokumenti Sqarues

Neni 1

Neni i parë përcaktonte se "Rregullat e Tarifave do të zëvendësojnë Rregullën ekzistuese të Çmimeve dhe Metodologjinë e Tarifave të nxjerra nga ZRRE". Megjithëse ky dokument quhet "Rregullat e Tarifës së Energjisë Elektrike", ai mbulon jo vetëm rregullat por edhe disa aspekte të metodologjisë. Megjithatë, ligji përcakton se KOSTT është përgjegjës për Metodologjinë e Tarifave të Transmisionit, ndërsa përgjegjësi e vetme e ZRRE-së është që ta miratojë atë metodologji. Në

nenin e dytë të këtij dokumenti vihet në pah se ZRRE është përgjegjëse për miratimin e metodologjive të propozuara nga OST.

Neni 2

Pika e pestë e këtij neni përcakton se "Kjo Rregull përcakton të hyrat e lejuara që duhet të mbulohen nga ngarkesat e transmisionit.". Ky dokument nuk i cakton të hyrat e lejuara, ai përcakton parimet për caktimin e të hyrave të lejuara. Të hyrat e lejuara caktohen gjatë secilit rishikim periodik të çmimeve.

Neni 3

Në pikën e gjashtë të nenit 3.1.1 të këtij dokumenti përcaktohet metoda për caktimin e cakut të humbjeve. Në të nuk merren parasysh humbjet inkrementale të cilat do të shfaqen si rezultat i shtimit të nivelit të energjisë që bartet në sistem nga viti në vit, dhe kjo duhet të korrigjohet.

Pika e fundit e nenit 3.2.1 propozon që dallimi mes humbjeve aktuale dhe humbjeve të parashikuara të ndahet dhe që OST të merr fillimisht 50% të kësaj pjese. KOSTT pajtohet në parim me principin e ndarjes, por beson se rreziku me të cilin përballet nëse merr përsipër 50% të humbjeve që tejkalojnë ato të parapërcaktuarat do të ishte tejet i madh. Rrjedhimisht, KOSTT propozon që nëse kostoja e humbjeve tejkalon caqet e parapërcaktuara, faktori i ndarjes të jetë vetëm 25%. Në bazë të aranzhimeve aktuale, KOSTT nuk eksponohet ndaj kostos në rast se humbjet aktuale janë më të larta se sa ato të caktuara, kësisoj mekanizmi i propozuar i ndarjes do t'i sjell përfitime konsumatorëve dhe do të paraqesë masë stimuluese për KOSTT-in.

Në paragrafin e katërt të nenit 3.2.2 të dokumentit thuhet se "Evidenca mbi koston e realizuar do të përdoret nga ZRRE-ja për aprovimin e kostove investive në të ardhmen". Ky nuk mund të jetë i vetmi faktor që ZRRE merr parasysh, pasi që shumë projekte kapitale lidhur me transmisionin janë unike dhe duhet të merren në konsideratë duke marrë parasysh meritat e tyre dhe jo vetëm koston nga e kaluara, gjithashtu, ZRRE duhet të merr parasysh faktorë të tjerë, siç është kostoja e shtuar e ndërtimit. ZRRE gjithashtu duhet të ketë parasysh se shtimi i kostos mund të ndodh edhe për shkak të faktorëve që nuk janë nën kontroll të KOSTT-it.

Në nenin 3.5 të dokumentit thuhet se "Pas konsultimeve me OST-në, ZRRE-ja do të publikojë një vendim të përkohshëm". KOSTT beson se do të ishte më e përshtatshme që OST të shqyrtojë këtë vendim para publikimit të tij, për të siguruar se ai është faktikisht i saktë dhe për të siguruar se KOSTT është i njoftuar me të gjitha çështjet të cilat mund të ndikojnë në funksionimin e tij, para se ai të publikohet.

Rivlerësimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve

KOSTT mirëpret vendimin për të rivlerësuar Bazën së Rregulluar të Aseteve (RAB). Ka kohë që kur KOSTT ka ofruar argumente lidhur me faktin se metoda që aktualisht përdoret për vlerësimin e RAB-it e nënvlerëson vlerën e vërtetë të tyre dhe do të rezultojë me vështirësi në financim në të ardhmen.

Neni 3.2

Neni 3.2 sqaron se propozimi i ZRRE-së për t'i shtuar investimet në RAB, bazuar në kostot e investimeve që miratohen nga ZRRE dhe jo në koston aktuale të tyre. Megjithëse kjo është korrekte dhe do të paraqesë masë stimuluese për KOSTT-in sa i përket kontrollimit të shpenzimeve të veta kapitale, ajo nuk merr parasysh situatat kur kostoja ndryshon në masë të theksuar për arsye të cilat nuk janë nën kontroll të KOSTT-it, siç janë p.sh. rritjet e kostove në kontrata, për shkak të ngritjes së çmimeve botërore të metalit.

Neni 5.1

ZRRE thotë se e vetmja qasje praktike në vlerësimin e aseteve të para vitit 2006 është shfrytëzimi i vlerësimeve të përcaktuara në llogaritë statusore më 1 janar 2006. Megjithatë, kjo vlerë paraqet koston e zëvendësimit të aseteve të zhvlerësuara, siç përshkruhet në Figurën 2. Zhvlerësimi vlerësohej në raport me normat e inkasimit në kohën kur KEK-u dhe KOSTT-i ishin një entitet, kështu që të gjitha asetet janë shlyer. Kur KOSTT-i u nda nga KEK-u, inkasimi nuk paraqiste më problem për KOSTT-in, kështu që arsyeja për shlyerjen e aseteve të KOSTT-it më nuk ekzistonte. Për këtë arsye, KOSTT fuqimisht beson se vlera e RAB-it për asetet para vitit 2006, do duhej të jetë ajo e datës 1 janar 2006, pas zbrazjes së zhvlerësimit.

KOSTT nuk i ka të qarta vlerat që ZRRE i ka shfrytëzuar në Tabelën 1 për të paraqitur ndikimin e rivlerësimit të RAB në tarifa, dhe kërkon më shumë detaje lidhur me to. Për më tepër, siç thuhet më lartë, kalkulimet do duhej të bazoheshin në vlerat e aseteve të vitit 2006, pas largimit të zhvlerësimit, i cili në rastin e KOSTT-it nuk është më i zbatueshëm.

Neni 5.2

ZRRE propozon që asetet para vitit 2006 të zhvlerësohen në mënyrë lineare gjatë një periudhe 24 vjeçare. Kjo do të mundësoj lejim për zhvlerësim në masë prej 1/30 nga vlera bruto e aseteve gjatë 24 viteve dhe do të pamundësojë këtë pas skadimit të kësaj kohe. Kjo nuk reflekton jetëgjatësinë reale të këtyre aseteve, disa prej të cilave në vitin 2006 kishin jetëgjatësi tejet të shkurtë të mbetur, ndërsa jetëgjatësia e të tjerave do ta tejkalojë bindshëm këtë periudhë 24 vjeçare. KOSTT beson se metodologjia e zvogëlimit të bilancit të zhvlerësimit, duke bërë që jetëgjatësia rregullative e aseteve të jetë 35 vite, do të përputhej më mirë me jetëgjatësinë e vërtetë të këtyre aseteve.

Një qasje e ngjashme për asetet e kohës para marrjes së obligimeve është shfrytëzuar nga Ofgem në rastin e aseteve të transmisionit dhe shpërndarjes, por kjo ka rezultuar me një 'boshllëk në financim', kur asetet e kohës para marrjes së obligimeve janë zhvlerësuar në zero dhe kjo e ka obliguar Ofgem-in që të aplikojë mekanizma tjerë për të kompensuar këtë. Metodologjia e zvogëlimit të bilancit nuk do të rezultojë me ndonjë ndryshim të theksuar të lejimeve për zhvlerësim (dhe rrjedhimisht të të ardhurave të lejuara) dhe do t'i shmangej këtij problemi.

Neni 6

Në këtë nen thuhet se vlera e RAB-it do të indeksohet çdo vit, duke e shfrytëzuar CPI-në e Kosovës. Dokumenti "Rregulla për vënien e çmimeve të OST" thotë se kostoja do të indeksohet çdo vit në bazë të CPI-së së Eurozonës. Këtu nuk ka konsistencë. KOSTT beson se do të ishte më e rrugës që të shfrytëzohet CPI e Kosovës, pasi që ajo më saktë i reflekton ndryshimet në çmime me të cilat KOSTT-i (dhe konsumatorët fundorë përkatës) përballen.

KOSTT mendon se nuk është e përshtatshme që ky dokument të quhet "Rregull". Mendimi ynë është se dokumenti duhet të referohet si vendim rregullativ.

Neni 3

1.2 "Plan i Aprovuar Investiv" e ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 2. Përkundër faktit që Shtojca 2 përdor termin "Plan i Aprovuar Investiv", ajo nuk e përkufizon atë.

1.31 Përkufizon "Njësitë e Rregulluara të Shpërndara". Për OST duhet të jetë "Njësitë e Rregulluara të Transmetuara"

1.38 Dokumenti i referohet "Deklaratës për Parimet e Ngarkesave të Transmisionit" mirëpo KOSTT nuk është në dijeni se ky dokument ekziston apo se kur do të nxirret nga ZRRE-ja.

1.42 Përkufizimi i "Humbjeve në Transmision" përfshin humbjet komerciale. Humbjet në Transmision zakonisht nuk i përfshijnë humbjet komerciale.

1.48 "Njësia e Shpërndarë" mund të referohet edhe në MWh, GWh etj.

Neni 4

Paragrafi 4 shpjegon nevojën për t'i zbritur të hyrat nga transiti nga të Hyrat Maksimale të Lejuara. Megjithatë, ky paragraf nuk është i qartë lidhur me mënyrën se si do të llogariten këto të hyra nga transiti, si mund të ndërlidhen këto të hyra me asete të caktuara, apo se çka ndodh nëse ato asete janë të financuara nga donatorë ashtu që nuk ka fare të hyra për to në MAR.

Neni 6

Paragrafi 3.3 i referohet ndarjes për nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e humbjeve. Ai nuk shpjegon se si do të përcaktohet kjo ndarje; p.sh. a do ta përcaktojë ZRRE mekanizmin për ndarje, apo këtë do ta bëjë KOSTT?

Paragrafi 4 i referohet formulës për përcaktimin e MAR. Ky dokument do të duhej të përcaktonte parimet për përcaktimin e MAR dhe jo të përmban formulën që duhet aplikuar. Si e tillë, formula mund të ndryshohet duke i zbatuar po këto parime. Ky koment aplikohet edhe për formulat tjera, siç është ajo për përcaktimin e WACC.

Neni 8

Paragrafi 3.3 i referohet ndërmarrjeve të ngjashme në Kosovë. KOSTT nuk është në dijeni të ekzistencës së ndërmarrjeve tjera të transmisionit në Kosovë me të cilat do të bëhej ndonjë krahasim i mirëfilltë.

Neni 12

Kjo pjesë shtjellon humbjet mirëpo nuk merr në konsideratë kostot e Shërbimeve tjera Ndihmëse siç janë rezerva sekondare dhe terciare, etj. Të gjitha këto kosto duhet të merren parasysh në mënyrën e duhur.

Neni 18

Paragrafi 1.1 përcakton se OST do t'i mbulojë kostot e operatorit të tregut. OST referohet në tërë Dokumentin gjersa do të ishte më e përshtatshme që referenca të bëhet në OSTT.

Kapitulli 4

Ky kapitull titullohet "Ngarkesat për TUOS" mirëpo ka të bëjë vetëm me "Përdorimin e Sistemit të Rrjetit të Transmisionit (TNUOS) – duhet të riemërohet në përputhje.

Shtojca 1

KOSTT nuk mendon se është e përshtatshme që të përfshihen detaje të formulave në këtë dokument. Dokumenti duhet t'i përfshijë vetëm parimet që përdoren në përcaktimin e formulave. Megjithatë, komentet tona në formulat e përfshira janë paraqitur si në vijim:

- Termi a_t përfshin referencë në numrin e konsumatorëve. Kjo nuk është relevante me Transmisionin, por vetëm me Shpërndarjen;
- Përkufizimi i a_t, b_t dhe c_t në versionin e gjuhës angleze të dokumentit përfshin termin d_t. Nuk ka d_t.
- Masa e CPI është e Eurozone, jo e Kosovës. KOSTT mendon se është më e përshtatshme që të përdoret CPI e Kosovës.
- Formula i referohet Njësive të Rregulluara të Shpërndara, duhet të jetë Njësive të Rregulluara të Transmetuara
- KOSTT nuk i kupton komponentët e Kostove të Lejuara të Humbjeve në formulën në paragrafin 2.2. Do kërkojmë nga ZRRE që ta kontrollojë dhe ta qartësojë këtë formulë.
- Norma e interesit e propozuar në këtë formulë është EURIBOR plus 1%. KOSTT beson se kjo nuk është normë e duhur dhe mendon se duhet të përdoret një normë që pasqyron më saktë koston e financimit për KOSTT (p.sh. kostot e huamarrjes në Kosovë).
- LSSCat-1 është përkufizuar dy herë – ka nevojë të përkufizohet vetëm një herë.
- Përkufizimi i Faktorit të Ndarjes së Humbjeve thekson që ai do të përcaktohet në Shqyrtime Periodike duke mos dhënë shpjegime se si do të përcaktohet.

Shtojca 2

Paragrafi 4.2 thekson se asetet e shitura do të zbriten nga RAB bazuar në vlerën e rregulluar të asetit që shitet. Çdo fitim apo humbje në shitje trajtohet përmes një përshtatjeje në MAR në periudhën vijuese rregullative. Kjo nënkupton se duhet të mbahen shënime të vlerave të aseteve rregullative për çdo aset individual, e jo në baza të aseteve të grumbulluara, si dhe se vlera e vitit 2006 duhet të

shpërndahet në asetet që kanë ekzistuar në atë kohë. Do të ishte më e thjeshtë që të zbriten të hyrat nga shitja nga RAB (duke i trajtuar si kontribut në koston e RAB) dhe pastaj nuk do të kishte nevojë që të mbahen shënime të aseteve individuale dhe nuk do të kishte nevojë për trajtim të veçantë të fitimit apo humbjes në shitje.

Paragrafi 4.3 thekson se asetet do të hyjnë në RAB bazuar në shpenzimin e aprovuar dhe nuk do të përshtaten për shpenzimet aktuale. KOSTT beson se do të ishte më mirë të përshtaten ndryshimet në kostot aktuale nëse arsyet për ato ndryshime janë të faktorëve jashtë kontrollit të KOSTT-it. Nëse ndryshimi është si pasojë e efikasitetit apo mosefikasitetit të KOSTT-it, atëherë mund të përdoret shuma e aprovuar fillestare. Gjithashtu, paragrafi 4.3 është në papajtueshmëri me paragrafin 4.4 ku theksohet se nëse nuk realizohen shpenzimet atëherë RAB do të bazohet në shpenzimet aktuale (d.m.th. zero) e jo shpenzimet e planifikuara.

Paragrafi 6 thekson se shpenzimet e aprovuara kapitale (të cilat janë bazë për rritje në RAB) do të bazohen në Planin e Aprovuar Investiv për Periudhën vijuese Rregullative. Megjithatë, meqë Periudha Rregullative është 5 vjeçare, Plani Investiv do të ndryshojë gjatë kësaj kohe; metodologjia e propozuar nuk duket se lejon ndryshime në rritjet e RAB për ndryshimet valide në planin investiv gjatë kësaj periudhe.

Paragrafi 6.5 thekson se Plani Investiv do të bazohet në teknika të diskontimit të rrjedhës së parasë. Çfarë teknika të d.rr.p. propozohen dhe si do të përdoren ato. Shumë investime kapitale janë të domosdoshme për arsye tjera, ndryshe nga ndikimi i tyre në rrjedhë të parasë, si do të përfshihen ato.

Shtojca 3

Përkufizimi i gi thekson se është raporti borxh:ekuitet. Duhet të jetë borxhi/(borxhi+ekuiteti).

Termet kanë prapashtesa i për firmën i. Është vetëm një kompani transmetimi, nuk ka nevojë për prapashtesa.

KOSTT është i shqetësuar me përdorimin e financimit miks për kompanitë e ngjashme ndërkombëtare sepse një miks i tillë mund të mos jetë i përshtatshëm, madje as i arritshëm për një kompani në Kosovë.

Nuk është marrë parasysh risku i shtetit gjatë përcaktimit të WACC me përdorimin e krahasuesve ndërkombëtarë. Risku i shtetit shton në masë të konsiderueshme koston e kapitalit në Kosovë dhe ai duhet të merret parasysh.

Paragrafi 4.1 detyron OST-në që të prokurojë kredi përmes procesit konkurrues. Në praktikë shumë kredi ofrohen përmes agjencive ndërkombëtare financuese apo janë të lidhura me grantet e pranuara dhe në këtë mënyrë nuk arrihen përmes proceseve konkurruese. Përdorimi i procesit konkurrues rrit në masë të madhe koston e huamarrjes për KOSTT.

Shtojca 4

Kjo Shtojcë shtjellon Shërbimet e Përjashtuara mirëpo dokumenti nuk ofron shpjegim lidhur me trajtimin e të hyrave nga shërbimet e përjashtuara në lidhje me llogaritjet e MAR.

Shtojca 5

Paragrafi 5 thekson se OST do të aplikojë "metodologjinë e përcaktuar në këtë rregull". Duhet të jetë "parimet e përcaktuara në këtë rregull".

Paragrafi 7 lejon Rregullatorin që të ndryshojë çdo pjesë të kërkesave të OST-së nëse konsideron se një gjë e tillë është e duhur. Kjo do të duhej të bëhej vetëm pas konsultimeve me OST.

Përgatitur nga: KOSTT